



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE TË PËRLLOGARITJES DHE NIVELET E
TARIFAVE QË U NGARKOHEN SUBJEKTEVE TË MBIKËQYRURA, SI DHE
PROCEDURAT E ARKËTIMIT DHE RAKORDIMIT TË TYRE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 155, datë 23.12.2014
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 69, datë 23.07.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 138, datë 28.09.2017
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 164, datë 30.11.2017
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 163, datë 30.07.2018
**Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 256, datë 29.12.2021*
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 132, datë 30.06.2022

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i elementeve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, pika 13 dhe nenit 27, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Neni 3
Llojet e tarifave

Autoriteti mbledh nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në tregjet që rregullon dhe mbikëqyr këto lloj tarifash:

- a. Tarifë për aplikim, dhënie dhe rinovime licencash, miratimesh dhe autorizimesh;
- b. Tarifë për mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara nga Autoriteti;
- c. Tarifë për projekte të veçanta prej të cilave përfitojnë subjektet e mbikëqyrura;
- d. Tarifë për trajnime për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim prej të cilave përfitojnë subjektet e mbikëqyrura.

Neni 4

Tarifa aplikimi, dhënie, rinovim licencash, miratimesh, autorizimesh

1. Subjekti që kërkon të pajiset me licencë, autorizim apo miratim detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit:
 - a. Tarifë për depozitimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për pajisje me licencë, apo autorizim, si dhe dhënie miratimi, e cila caktohet si tarifë fikse dhe paguhet në momentin e depozitimit të dokumentacionit në Autoritet. Tarifa për aplikim nuk i kthehet subjektit, nëse kërkesa e tij për miratim, licencim apo autorizim refuzohet nga Autoriteti;
 - b. Tarifë për pajisje me licencë, autorizim, miratim, apo rinovimin, e cila caktohet si tarifë fikse dhe paguhet nga subjekti përfitues, brenda 45 ditëve nga vendimi i Autoritetit për dhënien apo rinovimin e licencës, autorizimit, miratimit.

Neni 5

Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura

1. Subjekti që ushtron veprimtarinë në një nga tregjet që rregullon dhe mbikëqyr Autoriteti detyrohet të paguajë tarifën e mbikëqyrjes. Elementet e përlllogaritjes së tarifës së mbikëqyrjes janë si më poshtë:
 - a. Për shoqërinë e sigurimit të Jo-Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto vjetore nga veprimtaria e sigurimit;
 - b. Për shoqërinë e sigurimit të Jetës, elementi bazë është volumi i primeve të shkruara, pasi janë zbritur elementet e kursimit me bazë vjetore;
 - c. Për shoqërinë e risigurimit, volumi i primeve të shkruara bruto vjetore nga veprimtaria e risigurimit;
 - d. Për shoqërinë administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe depozitarin e fondeve, vlera e përgjithshme e asetëve të fondit/fondeve;
 - e. Për Bursën/PSHT/POT, vlera totale vjetore e transaksioneve të realizuara;
 - f. Për shoqërinë komisionere/bankën që kryen transaksione me Titujt e Qeverisë jashtë tregut të rregulluar, vlera totale vjetore e transaksioneve të tipit A, B dhe C, dhe vlera totale e transaksioneve të realizuara jashtë tregut të rregulluar për të gjithë titujt e tjerë;

- g. Për shoqërinë komisionere/bankën që operon në Bursë/PSHT/POT, vlera totale vjetore e transaksioneve në Bursë/PSHT/POT;
 - h. Për shoqërinë e brokerimit në sigurime, vlera totale vjetore e komisioneve të përfuara nga veprimtaria e ndërmjetësimit;
 - i. Për Bursën DLT, kategoritë A, B, C vëllimi i transaksioneve;
 - j. Për Kujdestarin e Portofolit të Palëve të Treta vlera e stokut të Tokëneve Digjital dhe/ose monedhave virtuale, në ditën e raportimit.
2. Niveli i tarifës që aplikohet mbi elementin e përlogaritjes të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni miratohet çdo vit nga Bordi i Autoritetit deri në nivelin 1.5%.
 3. Të gjithë subjektet e licencuara që nuk paguajnë një tarifë mbi bazën e elementeve të përlogaritjes të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, paguajnë një tarifë fikse mbi bazë vjetore, sipas përcaktimit në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Afati i pagimit të tarifës së mbikëqyrjes

1. Tarifa e mbikëqyrjes e llogaritur sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 5, të kësaj rregulloreje paguhet mbi bazë mujore brenda muajit pasardhës.
2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve vullnetare, Bursa/PSHT/POT, shoqëritë që operojnë në Bursë/PSHT/POT dhe jashtë tregut të rregulluar, si dhe shoqëritë e brokerimit në sigurime, të cilat paguajnë tarifën e mbikëqyrjes mbi bazë 3-mujore, brenda muajit pasardhës nga përfundimi i 3-mujorit. Për Bursën DLT, kategoritë A, B, C si dhe për Kujdestarin e Portofolit të Palëve të Treta pagesa e tarifës së mbikëqyrjes do të kryhet një herë në vit brenda muajit dhjetor.
3. Tarifa e mbikëqyrjes, e cila përcaktohet si tarifë fikse, sipas pikës 3, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, paguhet nga subjekti me dy këste. Kësti i parë paguhet brenda muajit korrik të vitit ushtrimor dhe kësti i dytë brenda muajit janar të vitit pasardhës.

Për vitin e parë të veprimtarisë, subjekti i licencuar paguan tarifën fikse në raport me kohën nga momenti i licencimit brenda muajit janar të vitit pasardhës.

Neni 7

Tarifa për projekte të veçanta

1. Tarifa për projekte të veçanta janë tarifatat që paguhet nga subjektet e mbikëqyrura për financimin e projekteve të veçanta dhe caktohen me vendim të Bordit të Autoritetit.

2. Nga projektet e veçanta përfitojnë subjektet e mbikëqyrura dhe të ardhurat nga këto tarifa përdoren vetëm për financimin dhe mirëmbajtjen e këtyre projekteve, sipas përcaktimeve të vendimit të Bordit të Autoritetit.

Neni 7/1

Shfuqizohet.

Neni 8 **Lista e tarifave**

1. Lista e detajuar e tarifave jepet në aneksin 1 dhe 1/1, të kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti rishikon listën e tarifave në varësi të zhvillimeve të tregjeve, nevojës për përmbushjen e detyrimeve të tij, kryerjes së investimeve dhe krijimit e mbajtjes së fondit të rezervës.
3. Lista e tarifave rishikohet dhe miratohet çdo vit në momentin e hartimit të buxhetit të Autoritetit.

Neni 9 **Pagesa e tarifave**

1. Subjekti paguan tarifën në llogaritë bankare të Autoritetit, të përcaktuara në Aneksin 2.
2. Në dokumentin bankar përshkruhet qartë emri i subjektit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si përfitues i tarifës, lloji i tarifës, periudha për cilën kryhet pagesa.

Neni 9/1 **Limiti i paradhënies për subjektet e mbikëqyrura**

Nëse shuma e paradhënies për subjektet e mbikëqyrura sipas përcaktimeve të paragrafit të fundit të nenit 27, të Ligjit 9572, datë 03.07.2006, i ndryshuar, është më e vogël se vlera 300 (treqind) lekë, kjo nuk do të konsiderohet si vlerë për t'u kthyer, por do të shpërndahet brenda tregut të subjektit të mbikëqyrur.

Neni 10 **Mos pagesa në afat e tarifave**

Mos pagesa e tarifave nga subjekti, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore përbën pengesë për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit dhe trajtohet si shkelje administrative sipas dispozitave të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, i ndryshuar.

Neni 11

Dispozita kalimtare

Çdo referencë në lidhje me tarifat dhe procedurën e arkëtimit të tyre, të përmendura në aktet e tjera nënligjore të Autoritetit, shfuqizohet.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.01.2015.

*Ndryshimet e kësaj rregulloreje dhe lista e tarifave sipas aneksit 1 dhe 1/1, hyjnë në fuqi më 1 janar 2022.

Aneks 1

LISTA E TARIFAVE

Nr.	Subjektet e tregjeve nën mbikëqyrje	Tarifë për depozitim dokumentacioni	Tarifë licencimi/miratime	Tarifë Mbikëqyrje
I. TREGU I SIGURIMEVE				
I.1	Shoqëri sigurimi/risigurimi			1.50%
	Licencim shoqëri sigurimi/risigurimi	20,000	250,000	
	Zgjerim veprimtarie e shoqërisë së sigurimit	10,000	100,000	
	Shtirrije veprimtarie e shoq. së sigurimit jashtë territorit të R.Sh.		10,000	
	Hapje zyrë përfaqësimi e shoq. së huaj të sigurimit në R.Sh.		20,000	
	Bashkim ose ndarje e shoqërisë së sigurimit		20,000	
	Delegimi i funksioneve të shoq. së sig. (për çdo funksion)		10,000	
	Miratim i pjesëmarrjes influencuese		20,000	
	Miratim statuti të shoq. së sigurimit		10,000	
	Miratim ndryshim statuti të shoq. së sigurimit		5,000	
	Transferim portofoli të shoq. së sigurimit		20,000	
	Miratim administrator/anëtar bordi drejtues/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		10,000	
	Riemërim administor/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		5,000	
I.2	Shoqëri brokerimi/ banka si shoqëri brokerimi			0.20%
	Licencim shoqëri brokerimi/banka shoqëri brokerimi	20,000	30,000	
	Miratim statuti të shoq. së brokerimit		10,000	
	Miratim ndryshim statuti të shoq. së sigurimit		5,000	
	Miratim administrator/anëtar bordi drejtues/anëtar i këshillit mbikëqyrës/ administrimi, për çdo kandidat		10,000	
	Riemërim administor/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		5,000	
	Broker - person fizik	2,000	20,000	0.20% si person fizik i regjistruar

I.3	Shoqëri agentësh/banka dhe subjekte të tjera si agjent	2,000	20,000	
	Agjent - person fizik	1,000	10,000	
	Punonjës shitës i shoq. së sigurimit		2,000	
I.4	Licencim aktuar	10,000	50,000	
	Rinovim licence		20,000	
I.5	Shoqëri për vlerësim dëme në sigurime	20,000	30,000	
	Vlerësues dëmsh - person fizik	10,000	50,000	
	Rinovim licence		30,000	
II. TREGJET E KAPITALIT				
II.1	Shoqëri komisionere/Banka për shërbime investimi			0.002% për transaksione me tituj të Qeverisë dhe tituj të tjerë jashtë tregut të rregulluar
				0.002% për transaksionet në Bursë/PSHT/POT
	Licencim shoqëri komisionere/banka për shërbime investimi	5,000	60,000	
	Zgjerim i veprimtarisë së shoqërisë komisionere/bankës	5,000	40,000	
	Regjistrimi i degës së shoqërisë së huaj komisionere	5,000	60,000	
	Njohja e shoqërisë së huaj komisionere	5,000	60,000	
	Miratimi i ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese		20,000	
	Miratim administrator, anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit/funksionar kryesor, për çdo kandidat		20,000	
	Riemërim administrator, anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		10,000	
	Veprimtari e administrimit të portofolit			0.01% e vlerës së asetëve nën administrim
	Veprimtari këshillimi për investime			100,000
	Veprimtari e nënshkrimit të instrumenteve financiare			100,000
	Shërbimi ndihmës lidhur me ruajtjen dhe administrimin e instrumenteve financiare në emër të klientëve			100,000
II.2	Subjekte të tjera			
	Regjistrimi i agjentit të lidhur		10,000	100,000
	Regjistrari i titujve/depozitar qendror	20,000	100,000	100,000

	Licencim i agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit	20,000	100,000	100,000
	Kundërpala qendrore/shtëpi klerimi	20,000	100,000	100,000
	Operimi i një platforme shumëpalëshe tregtimi (PSHT)/operimi i një platforme të organizuar tregtimi (POT)	50,000	300,000	0.001%
II.3	Bursa			0.001%
	Licencim burse	500,000	300,000	
	Miratim drejtor/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit të bursës dhe institucioneve të tjera të tregut, për çdo kandidat		20,000	
	Riemërim drejtor/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit të bursës dhe institucioneve të tjera të tregut, për çdo kandidat		10,000	
	Miratim i rregullave të bursës/operatorëve të tregut		20,000	
	Ndryshim rregullore		10,000	
II.4	Emetuesit për Oferta të Titujve			
	Miratim prospekti për instrumente financiare		100,000	
	Miratim suplementi/ndryshim prospekti		50,000	
	Regjistrim akt-oferte		50,000	
III. TREGU I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE				
III.1	Shoqëri administruese e fondeve			0.05%
	Licencim shoqëri administruese të fondeve	20,000	250,000	
	Zgjerim licence të shoqërisë administruese të fondeve		50,000	
	Njohja e shoqërisë së huaj administruese	20,000	250,000	
	Miratim administrator, anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit/ personeli kyç, për çdo kandidat		20,000	
	Riemërim administrator, anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		10,000	
	Ndryshim statuti		5,000	
	Miratim i pjesëmarrjes influencuese		20,000	
	Delegimi i funksioneve të shoqërisë administruese (për administrimin e portofoleve ose administrimin e riskut)		10,000	
	Licencim i SIK me oferte publike (fond investimi/shoqëri investimi) dhe miratim prospekti fond investimi/SIK	10,000	50,000	
	Regjistrim i Fondit të Investimeve Alternative (FIA/shoqëri investimi/shoqëri komandite)	50,000		
	Njohja e Sipërmarrjes së huaj te investimeve kolektive/ Administruesit të FIA të huaja		100,000	
	Ndryshim prospekti		20,000	

III.2	Depozitar i fondeve të investimeve			0.01%
	Licencim Depozitar	10,000	100,000	
	Zgjerim licence të depozitarit		30,000	
	Transferimi (zëvendësimi) i depozitarit	10,000	100,000	
IV. TREGU I PENSIONEVE VULLNETARE				
IV.1	Shoqëri administruese e fondeve të pensioneve			0.05%
	Licencim shoqëri administruese	20,000	250,000	
	Zgjerim licence		50,000	
	Miratim administrator/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		10,000	
	Riemërim administrator/anëtar i këshillit mbikëqyrës/administrimit, për çdo kandidat		5,000	
	Miratim statuti		10,000	
	Ndryshim statuti		5,000	
	Miratim prospekti fond pensioni		30,000	
	Ndryshim prospekti		10,000	
IV.2	Depozitar i fondeve të pensionit			0.01%
	Licencim depozitar	10,000	100,000	
	Zgjerim licence	30,000		
IV.3	Shoqëri agjentësh për fondet e pensionit	1,000	30,000	
	Agjent person fizik	500	10,000	

Llogaritja e detyrimit për tarifën e mbikëqyrjes së subjekteve të tregjeve të kapitalit është:

Llogaritja e detyrimit për tarifën e mbikëqyrjes së Shoqërisë komisionere/Bankës për shërbime investimi është:

Detyrimi 3 mujor = 0.01% të vlerës së aseteve nën administrim / 4 (për Administrim Portofoli)

Llogaritja e detyrimit mujor për tarifën e mbikëqyrjes së shoqërisë administruese të fondeve të investimit/SIK dhe depozitarit është:

Detyrimi mujor = Shuma e agreguar për çdo ditë të muajit e vlerës së përgjithshme të aseteve në fund të ditës X tarifa në % / 365

Llogaritja e detyrimit mujor për tarifën e mbikëqyrjes së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe depozitarit është:

Detyrimi mujor = Shuma e agreguar për çdo ditë të muajit e vlerës së përgjithshme të aseteve në fund të ditës X tarifa në % / 365

Llogaritja e detyrimit mujor për tarifën e mbikëqyrjes së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe depozitarit është:

Detyrimi mujor = Shuma e agreguar për çdo ditë të muajit e vlerës së përgjithshme të aseteve në fund të ditës X tarifa në % / 365

Aneks 1/1

LISTA E TARIFAVE

Nr.	Subjektet e tregjeve nën mbikëqyrje	Tarifë për depozitim dokumentacioni	Tarifë licencimi/ miratime	Tarifë Mbikëqyrje
I. TREGJET FINANCIARE TË BAZUARA NË TEKNOLOGJINË E REGJISTRAVE TË SHPËRNDARË				
1.1	Agjenti i Tokenit Digjital			
	Licencimi i Agjentit të Tokenit Digjital	100,000	250,000	100,000
	Miratimi i personave kyç		20,000	
	Riemërimi i personave kyç		10,000	
	Miratimi i ndryshimeve në rregulloret e brendshme të Agjentit TD		20,000	
	Miratimi i pjesëmarrjes influencuese të Agjentit TD		20,000	
	Miratimi i ndryshimeve në statut të Agjentit TD		10,000	
1.2	Bursa DLT			
	Licencimi i Bursës DLT, kategoria A	500,000	300,000	0.001%
	Licencimi i Bursës DLT, kategoria B	800,000	400,000	0.001%
	Licencimi i Bursës DLT, kategoria C	1,000,000	500,000	0.001%
	Miratimi i personave kyç		20,000	
	Riemërimi i personave kyç		10,000	
	Miratimi i ndryshimeve në rregulloret e brendshme të Bursës DLT		20,000	
	Zgjerimi i Licencës së Bursës DLT	50,000	200,000	
	Miratimi i pjesëmarrjes influencuese të Bursës DLT		20,000	
	Miratimi i ndryshimeve në statut të Bursës DLT		10,000	
1.3	Kujdestari i Portofoleve të Palëve të Treta			
	Licencimi i Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta	500,000	500,000	0.001%
	Miratimi i personave kyç të Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta		20,000	
	Riemërimi i personave kyç të Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta		10,000	
	miratimi i ndryshimeve të rregulloreve të brendshme të Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta		20,000	
	Zgjerimi i Licencës së Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta	100,000	300,000	
	Miratimi i pjesëmarrjes influencuese të Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta	20,000	100,000	

	Miratimi i statutit të Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta		20,000	
	Miratimi i ndryshimeve në statut të Kujdestarit të Portofoleve të Palëve të Treta		10,000	
1.4	ICO / STO			
	Autorizimi i Relacionit Prezantues të Ofertës Fillestare të Tokenit Digjital (ICO)		300,000	
	Miratimi i ndryshimeve në Relacionit Prezantues		50,000	
	Autorizimi i Prospektit të Plotë Ofertës së Tokenit Digjital të Titujve (STO)		0.03%, jo më pak se 100,000 dhe jo më shumë se 400,000	
	Autorizim i akt-ofertës së Tokenit Digjital të Titujve (STO)		0.02%, jo më pak se 50,000 dhe jo më shumë se 200,000	
	Miratimi i ndryshimeve në Prospektin/Akt-ofertën e STO		50,000	

Llogaritja e detyrimit për tarifën e mbikëqyrjes për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë është:

Për Bursën DLT, kategoritë A, B, C:

Një herë në vit brenda muajit dhjetor = 0.001% të vëllimit të transaksioneve që ndodhin në bursë

Për Kujdestarin e Portofolit të Palëve të Treta:

Një herë në vit brenda muajit dhjetor = 0.001% të vlerës së stokut të tokenëve/ monedhave virtuale në ditën e raportimit jo më pak se 100,000 dhe jo më shumë se 500,000

Aneksi 2

Llogaritë bankare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Nr.	Emri i Bankës	Nr. i llogarisë dhe IBAN në Lekë	Nr. i llogarisë dhe IBAN në USD	Nr. i llogarisë dhe IBAN në Euro
1.	RAIFFEISEN BANK	0100 7999 28 AL 53202110130000000100799928	800 0799928 AL 37202110130000008000799928	8001799928 AL 84202110130000001799928
2.	TIRANA BANK	0100-304 913 102 AL 48206110040000100304913102	0100-304 913 101 AL 75206110040000100304913101	0100-304 913 100 AL 05206110040000100304913100
3.	CREDINS BANK	876 AL 87212110160000000000000876	3433 AL 15212110160000000000003433	3737 AL 52212110160000000000003737
4.	BANKA KOMBËTARE TREGTARE	501375570 AL 5720511519375570 CLPBCLALLS	AL 6820511519375570 CLPBCFUSDS	AL 1420511519375570 CLPBCFEURE
5.	INTESA SANPAOLO	201 9830701 AL 78208110080000002019830701	201 9830702 AL 51208110080000002019830702	201 9830703 AL 24208110080000002019830703